



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 27/1 Prot.

Tiranë, më 08/01/2025

V E N D I M (Qarkullues)

Nr. 01, datë 08.01.2025

PËR

**MIRATIMIN E DHËNIES SË NJË NDIHME TË MENJËHERSHME FINANCIARE
PËR PUNONJËSIT MBËSHTETËS DHE TË SPECIALITETEVE TË NDRYSHME
TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, neni 47, 49, pika 1, gërma ë, ligjin nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të RSH, neni 107, Vendimin nr. 846, datë 26.12.2024 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore”, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 27 prot, datë 7.01.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënen e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës dhe punonjësit e tjerë të specialiteteve të ndryshme, të cilët paguhen me klasën e VII në Universitetin Politeknik të Tiranës në masën:
 - 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.
2. Efektet financiare të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e institucionit dhe pagesa të kryhet në artikullin (606);
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit për kryerjen e veprimeve financiare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 28/1 Prot.

Tiranë, më 08/01/2025

VENDIM (Qarkullues)

Nr. 02 datë 08.01.2025

**“PËR DETAJIMIN E FONDEVE TË AKORDUARA NË FORMË GRANT
/TRANSFERTË E PAKUSHTËZUAR PËR VITIN 2025”**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 47, neni 49, 108 e vijues, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Vendimin Nr.13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik-Tiranë”, grantin e akorduar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit datë 06.01.2025, si dhe me propozim të Administratorit të Institucionit, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë detajimin e fondeve të akorduara Universitetit Politeknik të Tiranës, në formë grant/transfertë e pakushtëzuar, për vitin 2025, sipas tabelës bashkëngjitur;
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 308/1 Prot.

Tiranë, më 29/01/2025

V E N D I M

Nr. 03, datë 29.01.2025

P Ë R

MIRATIMIN E BURSAVE FINANCIARE DHE PËRJASHTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË BACHELOR DHE PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE, SI DHE MIRATIMIN E REDUKTIMIT TË TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË ME NOTË MESATARE 6(GJASHTË) E LARTË DHE STUDENTËT E CIKLIT TË DYTË, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar, Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar, Vendimin nr. 780, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programe të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”, Vendimin nr. 288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 308 prot., datë 27.01.2025, Bordi i Administrimit,



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDOSI:

1. Të miratojë bursat financiare dhe përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë Bachelor dhe në programin e integruar të studimeve, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për vitin akademik 2024-2025, sipas relacionit dhe listave bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë uljen e tarifës vjetore të shkollimit në masën 50% për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të dytë "Master i Shkencave" dhe "Master Profesional", të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për vitin akademik 2024-2025, sipas relacionit dhe listave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të miratojë uljen e tarifës vjetore të shkollimit në masën 50% për studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë ose në programin e integruar të studimeve, të cilët plotësojnë kriterin e notës mesatare 6 (gjashtë) e lartë, për vitin akademik 2024-2025, sipas relacionit dhe listave bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Për studentët që kanë plotësuar kriteret dhe kanë aplikuar rishtaz për bursë financiare gjatë vitit akademik 2024-2025, bursa financiare paguhet nga muaji pasardhës i aplikimit.
5. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 307/ Prot.

Tiranë, më 29/01 /2025

V E N D I M

Nr. 04 , datë 29.01.2025

P Ë R

MIRATIMIN E BURSAVE FINANCIARE DHE PËRJASHTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR STUDENTËT E VITEVE TË PARA QË NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË BACHELOR DHE PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE, TË CILËT KANË PËRFUNDUAR ARSIMIN E MESËM TË LARTË ME NOTË MESATARE 9-10, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar, Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 307 prot., datë 27.01.2025, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë bursat financiare dhe përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, për studentët e viteve të para, që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë Bachelor dhe në programin e integruar të studimeve, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë me mesatare 9-10, sipas relacionit dhe listave bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për studentët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë me mesatare 9-10, bursa financiare paguhet nga fillimi i vitit akademik.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

3. Ky vendim t'i njoftohet MAS dhe AKFAL, për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2025.
4. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3299/11 Prot.

Tiranë, më 29/01 /2025

V E N D I M

Nr. 05, datë 29.1.2025

PËR

MIRATIMIN E MBYLLJES SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT, QË NUK JANË
AKTIVIZUAR PËR MË SHUMË SE DY VITE AKADEMIKE

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 35, Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësjive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Kreu IV, C, pika 1, shkronja a, Vendimin nr.13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin e Senatit Akademik Nr.14, datë 28.03.2024, si dhe shkresën e Rektorit nr.3299, datë 23.12.2024 Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë mbylljen e programeve të studimit, që nuk janë aktivizuar për më shumë se dy vite akademike si më poshtë:
 - d) Master Profesional në Inxhinieri Tekstili dhe Modë, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
 - e) Master Profesional në Konstruksiione, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
 - f) Master Profesional në Teknologji Mekanike, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
 - ç) Master Profesional në Inxhinieri Ndërtimi, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
 - d) Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeofizike, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave;
 - dh) Master i Shkencave në Inxhinieri Industriale, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave;
 - e) Master i Shkencave në Inxhinieri GIS dhe Modelim Minerar, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave;
 - ë) Master Profesional në Inxhinieri Mekanike, “Profili Energjitikë”, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Kryetar
Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 182/ Prot.
12

Tiranë, më 29/01 /2025

V E N D I M

Nr. 06 , datë 29.1.2025

P Ë R

MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT TË
PËRPUTHSHMËRISË NË FAKULTETIN E INXHINIERISË SË NDËRTIMIT

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 116, pika 1, udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, pika 17, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, shkronja I, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, si dhe shkresën nr.182/1 prot, datë 28.01.2025 të Sektorit të Auditit të Brendshëm, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të auditimit të përputhshmërisë në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sektori i Auditimit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI

